



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Raport Konsultativ

Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative të Furnizuesit me Shërbim Universal

Shqyrtimi i Vlerave Hyrëse (2025-2027)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur me qëllim të informimit të palëve të interesit gjatë konsultimit publik. Raporti nuk paraqet vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë.

16 dhjetor 2024



Përmbajtja

1	Hyrje	4
2	Vlerat Hyrëse	5
3	Përcaktimi i Vlerave Hyrëse	6
3.1	Jetëgjatësia Ekonomike e Aseteve të lidhura me FSHU	6
3.1.1	Vlera ekzistuese	7
3.1.2	Përmbledhje e Aplikacionit të FSHU	7
3.1.3	Shqyrtimi dhe Propozimi i ZRRE-së	7
3.2	Marzha me Pakicë	9
3.2.1	Vlerat ekzistuese	10
3.2.2	Aplikacioni i FSHU	10
3.2.3	Shqyrtimi dhe Propozimi i ZRRE-së në lidhje me Marzhën me Pakicë të FSHU-së	11
3.3	Borxhi i Keq	13
3.3.1	Vlerat ekzistuese të FSHU	13
3.3.2	Aplikacioni i FSHU	13
3.3.3	Shqyrtimi dhe Propozimi i ZRRE-së në lidhje me Lejimin e Borxhit të Keq	14
3.4	Faktori Ndarës i Imbalanceve	17
3.4.1	Vlerat Ekzistuese të FSHU	18
3.4.2	Aplikacioni i FSHU	18
3.4.3	Propozimi i ZRRE-së për Faktorin Ndarës	18
4	Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes	18
4.1	Qasja e ZRRE	18
4.2	Vlerat ekzistuese të FSHU	19
4.3	Përshtatjet	20
4.3.1	Përshtatjet për përmirësimet e efikasitetit	20
4.3.1.1	Efkti i ndryshimit të kufirit të produktivitetit	21
4.3.2	Përshtatjet për inflacionin	21
4.3.3	Përshtatjet e tjera të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes	21



5	Propozimi për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative	22
----------	---	-----------



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në proces të shqyrtimit dhe përcaktimit të vlerave hyrëse dhe shpenzimeve operative për Furnizuesin e Shërbimit Universal – FSHU, për periudhën 1 Prill 2025 - 31 Mars 2027. Ky shqyrtim bazohet në mandatin ligjor dhe obligimet që dalin nga Rregulla¹ për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU).

Vlerat hyrëse janë parametrat kryesorë të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të rregulluara të Furnizuesit të Shërbimit Universal.

Rregulla për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin e Shërbimit Universal përcakton se gjatë shqyrtimit të vlerave hyrëse ZRRE vendos vlerat e disa parametrave që ndikojnë në nivelin e të hyrave të lejuara të FSHU-së. Vlerat hyrëse që do të përcaktohen në procesin e shqyrtimit janë:

- Jetëgjatësia ekonomike e aseteve të lidhura me FSHU;
- Marzha me pakicë;
- Niveli i lejuar për borxhet e këqija;
- Faktori ndarës i imbalanceve; dhe
- Ndonjë parametër tjetër hyrës që rregullatori mund ta konsiderojë të nevojshëm(faktori i efikasitetit) .

Në pajtim me kornizën rregullative dhe praktikat e ZRRE-së, përcaktimi i vlerave hyrëse zhvillohet përmes një procesi të hapur të konsultimit publik, ku palët mund të paraqesin komentet dhe vërejtjet e tyre lidhur me vlerat e propozuara nga ZRRE. Ky Raport Konsultativ përmban propozimet fillestare për vlerat hyrëse për FSHU për periudhën 1 prill 2025– 31 mars 2027, duke përfshirë gjithashtu shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes.

ZRRE fton të gjitha palët e interesit që të analizojnë dhe komentojnë të dhënat dhe qëndrimet e ZRRE-së të ofruara në këtë Raport Konsultativ, me të cilat mund të mos pajtohen, dhe t'i komentojnë duke ofruar fakte, kundër-argumente ose duke ofruar të dhëna shtesë që ZRRE mund të mos i ketë pasur parasysh gjatë propozimit fillestar. Komentet për këtë raport konsultative mund të dorëzohen me shkrim në adresën elektronike ero.pricing-tariffs@ero-ks.org ose të dorëzohen në formë të shtypur në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit për Energji
Departamenti për Tarifa dhe Çmime
Rr. Bekim Fehmiu (ish ndërtesa e Fazitës) kati i 2-të,
Prishtinë, 10000, Kosovë

¹ <http://ero-ks.org/2017/Rregullat/USS%20Pricing%20Rule.pdf>



Data e fundit për komente është 31 dhjetor 2024.

Pas shqyrtimit të komenteve të pranuara, ZRRE-ja do të publikojë Raportin Final së bashku me komentet e palëve dhe përgjigjet e ZRRE-së ndaj këtyre komenteve.

Dokumentet e ndërlidhura

Ligji për Rregullatorin e Energjisë	https://tinyurl.com/yc3rpdve
Rregulla për të Hyrat e FSHU	https://tinyurl.com/zpff9kr3
Propozimi i ZRRE-së për Vlerat Hyrëse të FSHU-së 2022-2024	https://tinyurl.com/5e7cm5dh
Raport përfundimtar për Vlerat Hyrëse 2022-2024	https://tinyurl.com/5acmfkzv
Raport Konsultativ për Vlerat Hyrëse 2022-2024	https://tinyurl.com/4umpvd54
Aplikacioni i FSHU-së për vlerat hyrëse	https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Modeli%20i%20Tregut/Propozimi%20per%20Vlerat%20Hyrese%20dhe%20Shpenzimeve%20Operative%20per%20Furnizuesin%20me....pdf

2 Vlerat Hyrëse

Rregulla për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU) përcakton metodologjinë për vendosjen dhe përditësimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale të Furnizuesit të Shërbimit Universal, të cilat mbulojnë kostot e ofrimit të shërbimit të rregulluara për konsumatorët e furnizimit universal (konsumatorët familjarë dhe konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal). Kjo rregullë përcakton të hyrat e rregulluara në një mënyrë që i mundëson furnizuesit të mbulojë kostot e shitjes me pakicë, kostot e blerjes së energjisë të nevojshme për furnizimin e konsumatorëve të FSHU-së dhe kostot e bartshme, përfshirë kostot e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Përshtatjet bëhen në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, duke u siguruar që FSHU të ketë likuiditet të mjaftueshëm financiar dhe që të ardhurat e rregulluara, të realizuara përmes aplikimit të tarifave, të llogariten saktësisht dhe në mënyrë të drejtë.

Të Hyrat e Rregulluara të FSHU varen nga Vlerat Hyrëse që përcaktohen gjatë shqyrtimeve të tyre. Në mënyrë që të promovohet parashikueshmëria e të hyrave, vlerat hyrëse përcaktohen për një periudhë rregullative prej 3 vitesh. Ndryshimet në vlerat hyrëse mund të bëhen vetëm në masën që këto



ndryshime janë *‘të arsyeshme, të justifikuara dhe të verifikuara me kujdes’* (neni 9.1 i Rregullës për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal).

Rregulla për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU-së) në Nenin 12, paragrafi 3 definon se vlerat hyrëse përbëhen nga:

- Jetëgjatësia ekonomike e aseteve të lidhura me FSHU;
- Marzha me pakicë;
- Niveli i lejuar për borxhet e këqija;
- Faktori ndarës i jobalancit;
- Kostot operative dhe të mirëmbajtjes;
- Faktori i efikasitetit; dhe
- Ndonjë parametër tjetër hyrës që rregulatori mund ta konsiderojë të nevojshëm.

Propozimet e FSHU për këto vlera hyrëse, dhe qëndrimet e ZRRE-së mbi to, janë ofruar në kapitullin 3 të këtij raporti.

3 Përcaktimi i Vlerave Hyrëse

Ky kapitull i Raportit Konsultativ ofron propozimet dhe argumentimet e FSHU për nivelin e vlerave hyrëse, si dhe qëndrimet e ZRRE-së për secilin prej propozimeve të paraqitura nga FSHU.

Qasja e ZRRE-së në përcaktimin e vlerave hyrëse për FSHU-në bazohet në vendosjen e vlerave efikase që mbulojnë kostot e arsyeshme të FSHU-së duke u bazuar në qëndrimet e kaluara të ZRRE-së. Më tej, ZRRE analizon nëse ka ndryshim të rrethanave të furnizimit të cilat do të mund të shtyjnë ZRRE-në të ndryshojë qëndrim nga vendimet e kaluara. Kjo qasje siguron parashikueshmëri rregullatore dhe konsistencë në vendimmarrje duke u bazuar në qëndrimet dhe vendimet e kaluara. Për secilin prej vlerave hyrëse të përcaktuara në këtë raport konsultativ, ZRRE ofron:

- Vlera ekzistuese që është përmbledhje e shqyrtimit të kaluar të vlerave hyrëse dhe nivelin e tyre për periudhën 2022-2024;
- Aplikacionin e FSHU për vlerat hyrëse për periudhën 2025-2027;
- Propozimin e ZRRE për vlerat hyrëse për periudhën 2025-2027.

3.1 Jetëgjatësia Ekonomike e Aseteve të lidhura me FSHU

Jetëgjatësia e aseteve përdoret për të llogaritur koston e zhvlerësimit të aseteve fikse të FSHU-së. Në përputhje me Rregullën për Çmimet, zhvlerësimi i aseteve llogaritet në baza lineare, duke përdorur Jetëgjatësinë Ekonomike të Aseteve, të përcaktuar për kategori të ndryshme të aseteve. Jetëgjatësia ekonomike e asetit dhe ajo teknike janë dy koncepte kyçe në vlerësimin e aseteve dhe projekteve në



sektorin e energjisë. Jetëgjatësia ekonomike e asetit për secilën klasë të asetëve konsiderohet se mund të përfaqësoj jetëgjatësinë teknike të asetit (d.m.th., periudhën para se të kërkohej zëvendësimi për shkak të konsumimit), përveç nëse ka arsye të mjaftueshme për të konsideruar që asetit duhet të zhvlerësohet para kësaj date.

3.1.1 Vlera ekzistuese

Gjatë shqyrtimit të vlerave hyrëse për periudhën 2022-2024, ZRRE kishte vendosur që jetëgjatësia ekonomike e asetëve të FSHU-së të ndahet në dy kategori, bazuar në analizën teknike dhe ekonomike të kryer gjatë shqyrtimit periodik për OSSH dhe OST/OT për periudhën 2018-2022. Jetëgjatësia mesatare e ponderuar e asetëve për pajisjet IT, kompjuterët, softuerët, licencat dhe patentat u caktua për 5 vjet ndërsa ajo e mobileve dhe pajisjeve të zyrës u caktua për 7 vjet².

3.1.2 Përmbledhje e Aplikacionit të FSHU

Sipas FSHU zhvillimi i shpejtë teknologjik ka bërë që teknologjia informative dhe pajisjet e lidhura me të të kenë një cikël jetësor më të shkurtër duke kërkuar përditësime dhe zëvendësime më të shpeshta. Për shembull, softuerët dhe pajisjet IT shpesh bëhen të papërdorshme brenda një periudhe të shkurtër për shkak të përmirësimeve të reja dhe kërkesave të rritura për siguri.

Jetëgjatësia e amortizimit të aktiviteteve, veçanërisht pajisjeve IT, duhet të reflektojë përparimet aktuale teknologjike dhe modelet e përdorimit. Historikisht, një periudhë amortizimi 5-vjeçare për kompjuterët dhe pajisjet e zyrës ishte e përshtatshme, por zhvillimet e vazhdueshme në teknologji kanë shkurtuar ndjeshëm jetën e tyre funksionale. Shumë studime dhe madje praktikant në disa vende të tjera sugjerojnë reduktimin e kësaj periudhe.

Rrjedhimisht FSHU propozon jetëgjatësinë ekonomike si më poshtë:

Tabela 1: Propozimi i FSHU-s për kategorizimin dhe jetëgjatësinë e asetëve

Grupet e Zhvlerësimit	Jetëgjatësia e Aseteve
Pajisjet e zyrës	5 vite
Programet kompjuterike	3 vite

3.1.3 Shqyrtimi dhe Propozimi i ZRRE-së

ZRRE propozon që kategoritë e asetëve të mbeten të njëjta me ato të tanishmet dhe që jetëgjatësia e asetëve të mos ndryshojë nga operatorët e rregulluar ekonomik në sektorin e energjisë.

Propozimi i ZRRE-së bazohet në argumentet në vijim:

- FSHU propozon për ndryshim të kategorisë së asetëve, por nuk ofron detaje për pjesëmarrjen dhe ponderimin e asetëve brenda kategorive të propozuara. ZRRE bazuar

² Për analizë të detajuar të ZRRE shih kapitullin 3.3.2 të Raportit përkatës Konsultativ të ZRRE (vegëza në kapitullin e parë të këtij dokumenti).



në shembuj dhe precedentë rregullatorë ka ardhur në përfundim se softuerët mund të kenë jetëgjatësi më të shkurtër apo më të gjatë zhvlerësimi dhe është në juridiksionin e rregullatorëve. Megjithatë, jo të gjitha pajisjet e teknologjisë zhvlerësohen me të njëjtën normë si softuerët, veçanërisht pajisjet e teknologjisë informative dhe softuerët administrativë, të cilët shpesh kanë një jetëgjatësi që tejkalon periudhën 3-vjeçare.

- Duke marrë parasysh se kategorizimi i ZRRE-së përfshin "Pajisjet e punës, aparatet dhe veturat, kompjuterët, pajisjet TI dhe softuerët," jetëgjatësia e këtyre aseteve duhet të ponderohet sipas pjesëmarrjes së secilës nënkategori brenda këtij kategorizimi. Sa i përket pajisjeve të zyrës, jetëgjatësia ekonomike zakonisht varion nga 7 deri në 10 vjet, ndërsa për pajisjet TI dhe softuerët, ajo varion nga 3 deri në 8 vjet³, sipas praktikave ndërkombëtare: Gjermania (3), Greqia (5), Irlanda (8), Italia (5), Japonia (3-5), Spanja (>5), Portugalia (3), dhe SHBA (3-5).

Duke pasur parasysh këtë, ZRRE propozon që si mesatare, norma e zhvlerësimit të vazhdojë të jetë 5 vite.

- Sa i përket jetëgjatësisë së mobileve dhe pajisjeve të zyrës, FSHU nuk ofron argumente të mjaftueshme për të justifikuar pse jetëgjatësia e tyre duhet të ndryshojë nga ajo e aplikuar gjatë vitit të kaluar, apo si kjo mund të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e standardeve të cilësisë së shërbimit. Në mungesë të këtyre argumenteve, ZRRE propozon që jetëgjatësia e mobileve dhe pajisjeve të zyrës të vazhdojë të jetë 7 vite.
- Në procesin e fundit të Shqyrtimit Periodik për Periudhën e Tretë Rregullatore 2023–2027, ZRRE ka vendosur që jetëgjatësia e aseteve në lidhje me pajisjet për zyrë, mobiljet dhe infrastrukturën e TI-së për Operatorin e Sistemit të Transmisionit – Operator Tregu (KOSTT) dhe për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) të jetë:
 - 5 vite për pajisjet e IT, softuerë, licenca dhe patenta dhe
 - 7 vite për mobile dhe pajisje për zyrë.

Duke marrë parasysh se operatorët e sistemit të energjisë elektrike në Kosovë – KOSTT, KEDS dhe FSHU – operojnë në kushte të ngjashme, ZRRE propozon që edhe jetëgjatësia e aseteve ekonomike të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) të jetë në të njëjtin nivel: 7 vite për pajisje të zyrave dhe 5 vite për IT, softuerë, licenca, patenta, etj. Bazuar në të dhënat e theksuara më lart, ZRRE propozon që jetëgjatësia ekonomike e aseteve të lidhura me FSHU të mbetet si më parë:

³ Worldwide Capital and Fixed Assets Guide 2024: https://www.ey.com/en_gl/technical/tax-guides/worldwide-capital-and-fixed-assets-guide



Tabela 2: Propozimi i ZRRE-së për kategorizimin dhe jetëgjatësinë e aseteve për FSHU

Grupet e Zhvlerësimit	Jetëgjatësia e Aseteve
Mobiljet, Pajisjet për zyrë	7 vite
Pajisjet e punës, veturat, kompjuterët, pajisjet TI dhe softuerë dhe programet kompjuterike etj.	5 vite

3.2 Marzha me Pakicë

Marzha me pakicë është kthimi i përqindjes që i lejohet FSHU-së të fitojë mbi kostot e blerjes me shumicë të energjisë elektrike, duke e kompensuar atë për rrezikun që merr përsipër në tregtimin e vëllimeve për ofrimin e shërbimit të rregulluar. Pra marzhi/fitimi i shitjes me pakicë në sektorin e energjisë përfaqëson diferencën midis çmimit të blerë nga furnizuesi (zakonisht nga prodhuesit dhe tregu) dhe çmimit me të cilin ajo energji shitet te konsumatorët fundor.

Rëndësia e Marzhit me pakicë:

Mbështet operacionet e FSHU: ndihmon furnizuesin për të mbuluar kostot administrative dhe investuar në përmirësimin e shërbimeve;

Nxit konkurrencën: në tregjet e liberalizuara aplikimi i këtij marzhi mund të ndihmojë furnizuesit të ofrojnë tarifa më të ulëta për konsumatorin; dhe

Siguron stabilitet financiar: një marzhë e përcaktuar drejtë garanton që furnizuesit mund të përballojnë ndryshimet e papritura në çmimet me shumicë.

Legjislacioni dhe korniza rregullative në Kosovë përcaktojnë se Furnizuesi me Shërbim Universal është një aktivitet i rregulluar në sektorin e energjisë. Si rezultat, kostot operative dhe faktorët e tjerë të lidhur me ofrimin e shërbimit ndaj konsumatorëve janë të paracaktuara nga ZRRE. Në këtë kuadër, FSHU duhet të planifikojë me kujdes kostot dhe sasitë e nevojshme të energjisë për të mbuluar kërkesat e konsumatorëve të tij.

Në përputhje me Rregullën për të Hyrat e FSHU-së, Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të sigurojë energji elektrike në mënyrë transparente, konkurruese dhe efikase. Gjithashtu, FSHU duhet të demonstrojë që çmimet e parashikuara të energjisë elektrike, që planifikon të prokurojë, janë të arsyeshme dhe të bazuara në praktika të drejta dhe të verifikueshme.

Kostot e lejuara të energjisë me shumicë ($WHPC_t$) duhet të llogariten sipas formulës:

$$WHPC_t = (GENC_t + IMPC_t + IMBC_t * IMBF_t) * (1 + RETM_t)$$

Kuptimi i secilës variabël në formulë është:

$GENC_t$	Kostot e lejuara të blerjes së energjisë nga gjeneratorët vendorë në vitin përkatës (t).
$IMPC_t$	Kostot e lejuara të energjisë së importit në vitin përkatës (t).
$IMBC_t$	Kostot neto të imbalancit në vitin përkatës (t).
$IMBF_t$	Faktori ndarës i imbalancit në vitin përkatës (t).
$RETM_t$	Marzha me pakicë në vitin përkatës (t).



Furnizuesi i Shërbimit Universal FSHU ka obligim që të propozojë fitimin e tij në baza konkurruese. Rregullatori përcakton nivelin e marzhës së fitimit duke e konsideruar si një fitim të arsyeshëm që reflekton rreziqet që furnizuesi merr përsipër gjatë ofrimit të shërbimit për konsumatorët e rregulluar. Për të përcaktuar këtë nivel, Rregullatori jo vetëm që vlerëson ekspozimin e FSHU-së ndaj rreziqeve të lidhura me ofrimin e shërbimit, por gjithashtu analizon krahasueshmërinë me marzhat e furnizuesve në vendet tjera të Evropës. Në veçanti, ky vlerësim fokusohet te vendet që kanë tregje me karakteristika të ngjashme me atë të Kosovës, duke u siguruar që marzha e përcaktuar të jetë konkurruese dhe në harmoni me praktikën ndërkombëtare.

3.2.1 Vlerat ekzistuese

Marzha me pakicë e vendosur nga ZRRE në shqyrtimin e kaluar të vlerave hyrëse është 2.54%. Kjo marzhë ishte llogaritur si mesatarja e kostove të marzhës të realizuara gjatë periudhës 2017-2021 dhe përkrahur me vendime të rregullatorëve në regjion.

3.2.2 Aplikacioni i FSHU

Sipas aplikacionit të FSHU llogaritja e marzhës me pakicë referuar Nenit 17 – nën-paragrafit 8.1 (metoda krahasimore për caktimin e marzhës me pakicë), nuk është e përshtatshme ngase mostrat adekuate krahasuese brenda Evropës janë të vogla, duke marrë parasysh se shumica e tregjeve evropiane i kanë liberalizuar tregjet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike. Pra, FSHU ka paraqitur aplikacionin për marzhën me pakicë, referuar Nenit 17 – nën-paragrafin 8.2 (kthim i arsyeshëm nga asetet fikse neto të përdorura për dhënien e shërbimit universal).

Bazuar në këtë, kërkesa e FSHU-s për marzhën me pakicë është paraqitur në Tabelën 3 si më poshtë:

Tabela 3: Kërkesa e FSHU-s për Marzhën me Pakicë 2025 – 2027

Përshkrimi		2025	2026	2027
Kapitali i përdorur	a	106,683	112,704	118,460
Kostoja e kapitalit	b	8.68%	8.68%	8.68%
Kthimi në total	c = a x b	9,261	9,784	10,284
WCLC e supozuar	d	2,373	2,428	2,501
Kthimi i kërkuar neto	e = c - d	6,888	7,356	7,783
WHPC e vlerësuar	d	217,907	224,187	230,746
Margjina	e/d	3.2%	3.3%	3.4%

Shënim: Të gjitha vlerat janë në mijëra Euro.

Në arsyetimin e vlerave të propozuara të marzhës me pakicë, FSHU në aplikacionin e tyre, i referohet raportit të ACER “*Report Energy Retail and Consumer Protection Market Monitoring*”⁴, dhe thekson se furnizuesit kanë pasur vështirësi në menaxhimin e marzhave të tyre për shkak të rritjes së çmimeve në

⁴ ACER - CEER Energy Retail and Consumer Protection Market Monitoring Report 2023, September 2022



tregun me shumicë. Si pasojë, furnizuesit kanë pësuar një zvogëlim të marzhës së fitimit, duke vështirësuar stabilitetin e tyre financiar dhe menaxhimin e operimeve.

3.2.3 Shqyrtimi dhe Propozimi i ZRRE-së në lidhje me Marzhën me Pakicë të FSHU-së


ZRRE propozon që marzha me pakicë për FSHU të mbetet e njëjtë me nivelin aktual (2.54%) për arsyet si vijon:

- Marzha e përcaktuar në shqyrtimin e kaluar të vlerave hyrëse është vendosur si mesatare e realizuar e kompensimit financiar të FSHU-së për marzhën me pakicë gjatë viteve 2017-2021 e cila është e njëjtë me nivelin e periudhës rregullative 2022-2024. Si e tillë ajo reflekton kompensim adekuat mesatar afatgjatë për FSHU-në;
- FSHU nuk është ekspozuar ndaj rrezikut të vëllimeve të energjisë, për më tepër energjia nga KEK ofrohet me prioritet për FSHU me çmim të kontraktuar;
- Në tregun e rregulluar kur marzha nuk lidhet me tenderë por në kalkulimet e kostove të blerjes së energjisë me shumicë, furnizuesit ekspozohen ndaj një niveli më të ulët të rrezikut;
- Praktikant kanë treguar edhe në rastet kur janë rritur çmimet me shumicë janë ulur marzhet, përveç nëse furnizuesit kanë tendencë me i rrit çmimet për konsumatorët;
- Çmimet e energjisë elektrike me shumicë (importi) kanë një tendencë të stabilizimit/uljes pas krizës energjetike të vitit 2022⁵, ashtu siç është paraqitur në Figurën 1, më poshtë:

⁵ Wholesale prices of electricity in Central and Eastern Europe (CEE) from January 2017 to June 2024, by country (in euros/MWh): <https://www.statista.com/statistics/1094282/cee-wholesale-electricity-prices/>



Figura 1 Çmimet me shumicë në tregjet Evropiane 2015-2024



- Kostot e plota të FSHU-së njihen dhe përshtaten gjatë shqyrtimeve të rregullta dhe përshtatjeve vjetore tarifore.

Vërejtje dhe komente shtesë në aplikacionin e FSHU-së:

- FSHU i referohet raportit të ACER “*Energy Retail and Consumer Protection Market Monitoring*” dhe thekson se furnizuesit kanë pasur vështirësi në menaxhimin e marzhave të tyre për arsye të rritjes së çmimeve në tregun me shumicë. ZRRE thekson se (i) ky raport i referohet furnizuesve në tregun e hapur të cilët ekspozohen ndaj një niveli më të lartë të rrezikut në mungesë të garancive që u ofrohen furnizuesve të rregulluar me detyrim të shërbimit publik; (ii) argumenti mund të dërgojë drejt uljes së marzhës për FSHU-në pasi marzha me pakicë do të duhej të reflektonte lëvizjet në marzhat në kushtet e tregut të parregulluar për të shmangur shtrembërimet në treg.
- Mënyra alternative e llogaritjes së kthimit, të cilës i referohet aplikacioni i FSHU-së, tashmë ka precedent rregullator. Sipas këtij precedenti, prodhimi i marzhës me pakicë i aplikuar në kostot e blerjes së energjisë me shumicë nuk mund të jetë më i ulët se prodhimi në mes të kapitalit të angazhuar në asete fikse dhe mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit. Këtu nuk përfshihet kapitali punues për të cilin FSHU kompensohet sipas metodologjisë 30-ditëshe (30-day approach).

ZRRE bazuar në shpjegimet e lartëcekura propozon që marzha me pakicë për periudhën 2025 – 2027, të jetë në vlerën prej 2,54%.



3.3 Borxhi i Keq

Neni 16 i Rregullës për të Hyrat e FSHU-së përcakton se kostot e lejuara të borxhit të keq vendosen nga Rregullatori gjatë përcaktimit të vlerave hyrëse dhe do të llogariten duke aplikuar nivelin e lejuar të borxhit të keq në formulën për llogaritjen e të Hyrave të Rregulluara të Furnizuesit të Shërbimit Universal. Borxhi i keq dhe llogaritë e arkëtueshme janë dy koncepte të lidhura ngushtë në financa, që lidhen me menaxhimin e të ardhurave të papaguara nga klientët. Ato ndikojnë në rezultatet financiare dhe rrjedhën e parasë së gatshme të një kompanie.

3.3.1 Vlerat ekzistuese të FSHU

Niveli ekzistues i borxhit të keq i lejuar në të Hyrat Maksimale të Lejuara të FSHU për vitet 2022-2023-2024 ishte lejuar në 2.4%, 2.2% dhe 2.0% për të reflektuar pritshmëritë e ZRRE-së, për të përmirësuar nivelin e borxhit të keq në FSHU. Niveli i lejuar i ZRRE-së ishte caktuar bazuar në mesataren e vlerës së realizuar të borxhit të keq (2020-2021).

3.3.2 Aplikacioni i FSHU

FSHU propozon që niveli i borxhit të keq në të Hyrat e Lejuara Maksimale të rritet. FSHU konteston mënyrën e llogaritjes dhe vendosjes së borxhit të keq nga ZRRE për periudhën 2022–2024, ku vlerat kanë qenë: 2.4% në vitin 2022 dhe 2% në vitin 2024, duke u bazuar në nivelin mesatar të realizuar për periudhën 2017–2021, sipas Pasqyrave Financiare dhe parimeve të kontabilitetit (IFRS).

Në argumentimin e saj për nevojën e rritjes së borxhit të keq, FSHU paraqet shkallën e arkëtimit pas 12 muajve të faturimit, e paraqitur në Tabelën 4.

Tabela 4: Shkalla e arkëtimit të FSHU pas 12 muajve të periudhës së faturimit

Viti	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Mesatare
Mesviti	91.7%	91.7%	91.8%	93.0%	93.8%	94.8%	92.8%
Fundviti	93.5%	92.5%	94.0%	95.1%	95.9%	n/a	94.2%

FSHU sqaron se faturat që mbeten të papaguara për më shumë se 12 muaj kanë një probabilitet të ulët për t'u paguar në tërësi. Analiza e fuqisë së arkëtimit tregon se FSHU arrin të arkëtojë plotësisht të gjitha detyrimet deri në 12 muaj, por pas kësaj periudhe shkalla e arkëtimit bie në 75%, që do të thotë se 25% e borxheve të vjetra mbeten të pa arkëtuara. FSHU thekson se, përmes përpjekjeve dhe bashkëpunimit me përmbauesit, arrin një nivel të caktuar suksesi në arkëtimin e borxheve të vjetra.

Duke marrë parasysh arsyetimet e theksuara më lart, FSHU propozon që niveli mesatar i borxhit të keq të jetë 4.8%, siç është paraqitur në Tabelën 5, më poshtë:

Tabela 5: Borxhi i keq i vlerësuar duke supozuar një normë arkëtimi 75% për borxhin e vjetër (>12 muaj)

Viti	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Borxhi i pa-arkëtueshëm (mil. EUR)*	12.73	13.35	15.35	16.02	16.64	17.43
Energjia elektrike e faturuar (mil. EUR)	263.60	278.20	289.67	324.06	357.16	419.92



Borxhi i keq (%)	=a/b	4.8%	4.9%	5.3%	4.9%	4.7%	4.2%
------------------	------	------	------	------	------	------	------

Burimi: Raporti i FSHU

Bazuar në ato që u theksuan më lart, FSHU propozon një metodë alternative për vlerësimin e borxhit të keq përmes modelimit të humbjes së pritshme kreditore (ECL). Ky model segmenton të arkëtueshmet sipas vjetërsisë dhe cakton norma të mospagimit bazuar në performancën historike të arkëtimit. Kjo qasje ofron një vlerësim më të nuancuar, duke marrë parasysh rreziqet e ndryshme të mospagimit në faza të ndryshme. Vlerësimi përfundimtar i borxhit të keq, duke përdorur këtë metodologji, arrin në 4.9% të të ardhurave të faturuara.

Në vijim, FSHU, në arsyetimet për rritjen e borxhit të keq, shpreh shqetësimin se këto borxhe mund të rriten në të ardhmen për shkak të supozimeve të tyre për rritjen e çmimeve të energjisë elektrike. Kjo rritje, sipas FSHU-s, mund të ndodhë si pasojë e hapjes së tregut (funktionalizimi i ALPEX) ose renovimeve të planifikuara të Termocentralit Kosova B, që do të çonin në rritje të importeve.

FSHU kërkon që ZRRE të rivlerësojë parametrin e borxhit të keq për FSHU dhe konteston mënyrën e llogaritjes së borxhit të keq, e cila bazohet në dispozitat e kontabilitetit. Sipas FSHU-s, këto dispozita nuk pasqyrojnë në mënyrë adekuate rreziqet dhe sfidat reale me të cilat përballet FSHU.

Sipas analizave të veta dhe bazuar në të dhënat historike, FSHU mendon se intervali i borxhit të keq për periudhën e ardhshme rregullative duhet të variojë midis 4.8% dhe 6.2%.

FSHU gjithashtu shpreh brengën se hapja e tregut, si dhe rehabilitimet e planifikuara të termocentralit Kosova B, mund të shkaktojnë rritje të çmimeve e si pasojë edhe zvogëlim të nivelit të arkëtimit.

3.3.3 Shqyrtimi dhe Propozimi i ZRRE-së në lidhje me Lejimin e Borxhit të Keq

Referuar Nenit 16 të Rregullës për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit të Shërbimit Universal, ZRRE përcakton nivelin e borxhit të keq bazuar në:

- Vlerësimin e arkëtimit historike nga FSHU dhe aftësisë së FSHU-së për të arkëtuar borxhet nga klientët;
- Pasqyrat financiare të audituara;
- Zbatimin e masave ligjore dhe rregullative që lidhen me të drejtën e FSHU-së për të ndërmarrë veprime ndaj klientëve që nuk i përmbushin obligimet financiare; dhe
- Mbrojtjen e interesit të klientëve që janë pagues të rregullt të faturave.

Sipas vlerësimit të ZRRE-së, krahasuar me periudhën 2022 – 2024, prospekti i përmirësimit të arkëtimit nga FSHU është më i mirë për shkak të përfundimit të pandemisë COVID19 dhe ndikimeve të përkohshme në uljen e nivelit të arkëtimit si dhe aprovimit të metodologjisë për vendosjen e taksave për shkyçje dhe rikyçje që pritet të rrisë vigjilencën e konsumatorëve për shlyerjen me kohë të detyrimeve. Po ashtu efekt në përmirësimin e arkëtimit ka edhe Programi për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm me të ardhura mesatare nën 150 euro për anëtar për faturat e energjisë elektrike, i cili mbështetet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.



Ngjashëm me praktikën rregullatore të zbatuar në proceset e kaluara të caktimit të borxhit të keq, ZRRE sërish thekson se mos-inkasimi nuk mund të konsiderohet i tëri si borxh i keq, ngase mund të ketë vonesa në inkasim, mirëpo jo i tërë ky mos-inkasim rezulton të mbetet si borxh i keq.

Për të vlerësuar Humbjen/Rënien në Vlerë të Llogarive të Arkëtueshme (RNVLIA), ZRRE ka analizuar pasqyrat financiare për vitet 2020-2023. Nga analiza e të dhënave historike të dorëzuara nga FSHU dhe pasqyrave financiare ZRRE gjenë se raporti në mes vlerës totale të Borxhit të Keq dhe Faturimit Total për periudhën 2020 – 2024 është prej 3% në 1.1%. Kurse niveli mesatar i Rënies në Vlerë të Llogarive të Arkëtueshme (RNVLIA) për Periudhën 2020 – 2024 ka rezultuar të jetë 1.1%.

Tabela 6: Normat historike të mos-arkëtimit për periudhën 2020-2024

Faturimi	Unit	2020	2021	2022	2023	2024*	Total
Faturimi i energjisë	mil€	289.68	326.08	357.16	419.93	437.31	1,830.17
Faturimi i shërbimeve	mil€	1.77	2.08	1.84	1.34	1.31	8.34
Gjithsejtë faturimi	mil€	291.45	328.16	359.01	421.27	438.63	1,838.51
Arkëtimi	Unit	2020	2021	2022	2023	2024*	Total
Arkëtimi për energjinë e faturuar	mil€	264.11	315.83	344.81	386.33	419.68	1,730.77
Gabimet teknike	mil€			0.00	0.12	0.00	0.12
Parapagimet	mil€	8.37	5.63	10.31	7.44	8.53	40.29
Përmbaruesit	mil€	2.02	2.77	2.74	2.59	2.36	12.47
Shërbimet	mil€	1.31	2.17	1.89	1.43	1.32	8.13
Të hyrat nga arkëtimi i borxheve - KEK	mil€	0.00	0.04	0.10	0.06	0.06	0.26
KEK Marrëveshje	mil€	0.39	0.40	0.35	0.32	0.24	1.69
Gjithsejtë	mil€	276.20	326.84	360.21	398.17	432.19	1,793.61
Norma e mos-arkëtimit (b+c)/a	%	8.1%	2.3%	2.7%	7.4%	3.5%	4.7%
Humja në vlerë e LI/A	mil€	8.59	3.34	2.24	3.36	2.06	19.59
Humbja në vlerë e LI/A d/a	%	3.0%	1.0%	0.6%	0.8%	0.5%	1.1%

3.3.2.2 Ndikimi i derregullimit

ZRRE është në proces të hapjes së tregut të energjisë elektrike. Plani i punës për fillimin e këtij procesi është përgatitur dhe janë identifikuar kategoritë e konsumatorëve që nuk kualifikohen për furnizim nga FSHU. Meqë procesi i derregullimit të tregut është ende në fazën fillestare, ndikimi i këtij procesi në nivelin e borxhit të keq do të trajtohet pasi të jenë ofruar të dhënat nga FSHU për konsumatorët që furnizohen në tregun e lirë. Sidoqoftë, në këtë periudhë rregullatore, ashtu siç është vepruar në periudhën 2022–2024, do të vlerësohet vetëm ndikimi i daljes në treg të konsumatorëve të lidhur në nivelin 35kV dhe 10kV.



Tabela 7: Ndikimi i derregullimit në normën mesatare të arkëtimit

Efekti i derregullimit (të dhënat e 2022)	Norma e arkëtimit	Dallimi në pikë%
Mesatar 35, 10 dhe 0.4 kV	98.43%	
Mesatar 10 dhe 0.4 kV	98.40%	0.03%
Mesatar 0.4 kV	98.16%	0.27%

Norma mesatare aktuale e arkëtimit, duke përfshirë të gjithë konsumatorët e furnizimit universal në vitin 2022, ishte 98.43%. Shkalla mesatare e ponderuar e arkëtimit për konsumatorët në nivelet 10kV dhe 0.4kV zvogëlohet me 0.03% pas derregullimit të konsumatorëve 35kV, ndërsa shkalla e arkëtimit zvogëlohet me 0.27% me derregullimin e konsumatorëve në nivelet 35kV dhe 10kV.


3.3.2.2 Propozimi i ZRRE-së

ZRRE propozon që niveli i borxhit të keq që mbulohet nga të hyrat e lejuara të vazhdojë trendin e njëjtë me atë të nivelit ekzistues:

- Në vazhdim të praktikave të mëparshme, ZRRE do të vazhdojë të ofrojë nxitje financiare për FSHU-në që të arrijë nivele çdo herë e më efikase të mbledhjes së të hyrave të paarkëtuara.
- Trendi i uljes së nivelit të mos-inkasimit është i njëjtë me atë të vendosjes së realizuar të vlerave hyrëse (0.2% pikë përqindjeje në vit) dhe kjo është në përputhje me trendin mesatar historik të uljes së nivelit të lejuar të borxhit të keq dhe realizimeve të FSHU gjatë të njëjtës periudhë.



Figura 2 Niveli i lejuar i borxhit të keq për periudhën 2018-2024 dhe trendi 2025-2027



- Rrjedhimisht, ZRRE propozon që niveli i lejuar i borxhit të keq për periudhën 2025-2027 të ndjekë të njëjtin trend linear të uljes së përqindjes vjetore të borxhit të lejuar në periudhën 2022-2024.
- Propozimi i ZRRE për borxhin e keq:

Tabela 8: Propozimi i ZRRE-së për Borxhin e Keq

Propozimi i ZRRE për Borxhin e Keq	% e lejuar
2025	1.8%
2026	1.6%
2027	1.4%

3.4 Faktori Ndarës i Imbalanceve

Faktori ndarës i imbalanceve përfaqëson pjesën e kostove të balancimit që FSHU ka të drejtë t'ua bartë konsumatorëve të rregulluar. Kostot e balancimit janë ato që lindin për shkak të mospërputhjeve midis blerjeve aktuale të FSHU-së për të përmbushur kërkesën e konsumatorëve dhe parashikimeve të bëra më herët. Në një treg të madh dhe likuid të energjisë elektrike, furnizuesit pritet të menaxhojnë këto mospërputhje përmes parashikimeve të sakta dhe përmes blerjes dhe shitjes së energjisë në tregjet



likuide (si tregjet me kontrata të avancuara – *forward market*) në mënyrë që çdo imbalanc i mbetur të minimizohet.

3.4.1 Vlerat Ekzistuese të FSHU

Faktori Ndarës i Imbalanceve në vlerësimin e fundit të vlerave hyrëse të FSHU-së është vendosur në 100% për periudhën 2022-2024.

3.4.2 Aplikacioni i FSHU

FSHU thekson se qasja e kufizuar në numrin dhe llojllojshmërinë e burimeve të gjenerimit, së bashku me varësinë nga njësitë gjeneruese të vjetra dhe jofleksibile, kufizon aftësinë e sistemit për të qëndruar në balancë dhe për të operuar me kosto minimale.

Duke marrë parasysh edhe zhvillimet e tregut, përfshirë konsumatorët prodhues, hapjen e tregut dhe mundësinë e ndërrimit të furnizuesve, FSHU beson se faktori i ndarjes së imbalancave duhet të vazhdojë të aplikohet si 100%, të paktën deri në shqyrtimin tjetër periodik.

3.4.3 Propozimi i ZRRE-së për Faktorin Ndarës

Bazuar në shpjegimin lidhur me rrethanat aktuale dhe pritjet për integrim në tregun e përbashkët ALPEX, ZRRE pajtohet me propozimin e FSHU, që faktori ndarës prej 100% duhet të ruhet për periudhën 2025 deri në 2027. Megjithatë, ZRRE propozon që në rast të funksionalizimit të tregut brenda-ditës brenda periudhës 2025-2027 atëherë faktori i ndarës të vendoset në 50% duke filluar në vitin e funksionalizimit të tregut brenda-ditës. ZRRE do të përditësojë të hyrat maksimale të lejuara të FSHU-së gjatë përshtatjeve të rregullta vjetore për të reflektuar ndryshimet e nevojshme në rast të funksionalizimit të tregut brenda ditës.

4 Kostot Operative dhe të Mirëmbajtjes

Në Nenin 14 të Rregullës për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal përcaktohet se kostot e lejuara me pakicë përshijnë kostot që lidhen me furnizimin e konsumatorëve të rregulluar, dhe ato përfshijnë: (i) Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes; (ii) Kostot e korporatës; (iii) Kostot e zhvlerësimit; dhe (iv) Kosto tjera të cilat janë jashtë kontrollit të FSHU-së.

4.1 Qasja e ZRRE

Praktika e zakonshme e përcaktimit të shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes është që ato të lejohen në nivel që ZRRE i konsideron të arsyeshme në nivel të përgjithshëm, pa analizuar kategoritë individuale të kostove që përbëjnë shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPEX). Megjithatë, gjatë shqyrtimit të kaluar të vlerave hyrëse për FSHU-në, ZRRE kishte konstatuar se ishte e nevojshme që të analizohen të gjitha kategoritë e kostove të FSHU-së individualisht për të vlerësuar arsyeshmërinë e tyre. Në këtë shqyrtim të vlerave hyrëse dhe Opex-it, ZRRE propozon që shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për periudhën 2025-2027 të vlerësohen sipas praktikave të mëparshme të ZRRE. Sipas kësaj praktike, ZRRE vendosë shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes si vlerë totale që e konsideron



efikase. Mbi këtë vlerë aplikohet faktori i efikasitetit dhe inflacioni në pajtim me Rregullën për Çmimet e FSHU-së.

Rrjedhimisht, Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes në çdo vit (t) do të përcaktohen si vijon:

- Vlera fillestare: Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes të lejuara nga ZRRE për vitin t-1 (duke përfshirë inflacionin);
- Përshtatjet:
 - Përshtatjet për inflacionin në vitin t;
 - Përshtatjet për faktorin e efikasitetit (shih kapitullin më poshtë) në vitin t;
 - Çdo ndryshim tjetër të nevojshëm të Shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes.
- Logaritjet për secilën prej këtyre vlerave janë dhënë në kapitullin 4, më poshtë.

4.2 Vlerat ekzistuese të FSHU

Vlerat e lejuara të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes, të përmbledhura sipas natyrës së shpenzimeve (të kontrollueshme apo të pa kontrollueshme) janë dhënë në tabelën në vijim.

Tabela 9: Vlerat ekzistuese të FSHU-së 2022 -2024

	Njësia	2022	2023	2024
Efikasiteti	%	-	-0.1%	-0.1%
Opex i kontrollueshëm	€'000	3,331	3,328	3,325
Opex i pa-kontrollueshëm	€'000	1,839	1,839	1,839
Total		5,169	5,166	5,163

Duhet të qartësohet se vlerat e dhëna në Tabelën 9 janë paraqitur në terma real të vitit 2021 dhe nuk përfshijnë inflacionin vjetor i cili është reflektuar gjatë përshtatjeve të rregullta. Pas indeksimit me inflacion, vlera e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes për vitin 2024 është rreth €5.4⁶ milionë. Kjo vlerë do të përdoret si vlerë fillestare mbi të cilën do të përcaktohen shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për periudhën 2025-2027..

⁶ Vlera e lejuar e Shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes për vitin 2024 prej 5,467,389 EUR.



4.3 Përshtatjet

Ky nënkapitull i Raportit Konsultativ paraqet përshtatjet e shpenzimeve Operative dhe të Mirëmbajtjes mbi vlerën fillestare të ZRRE.


- Përshtatjet për përmirësimet e pritshme të efikasitetit (Kapitulli 4.3.1);
- Përshtatjet për inflacionin (Kapitulli 4.3.2);
- Përshtatjet për shpenzimet operative dhe mirëmbajtjes (Kapitulli 4.3.3).

4.3.1 Përshtatjet për përmirësimet e efikasitetit

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes i nënshtrohen një faktori të efikasitetit i cili reflekton përmirësimet e pritshme të efikasitetit operativ të kompanive të rregulluara. Ky faktor i efikasitetit reflekton përmirësimet që një operator i rregulluar duhet t'i realizojë në mënyrë që të arrijë nivelin e efikasitetit të një kompanie efikase të krahasueshme dhe përmirësimet eventuale që ajo kompani efikase mund t'i arrijë përgjatë periudhës rregullative. Rrjedhimisht, për vendosje të caktuar të efikasitetit për një kompani të rregulluar, ZRRE duhet të vlerësojë efikasitetin operativ të saj me një mostër kompanish të krahasueshme, të identifikojë nivelet e operimit të kompanive më efikase në atë mostër dhe pastaj të përcaktojë se si krahasohet kompania për të cilën po vendoset faktori i efikasitetit me kompanitë më efikase. ZRRE pastaj duhet të vendosë se sa pritët të jetë përmirësimi i përgjithshëm i efikasitetit për kompanitë më efikase dhe të përcaktojë faktorin e efikasitetit si shumën e këtyre dy faktorëve:

- Efekti i barazimit me kompanitë më efikase: Sa duhet të përmirësojë efikasitetin një kompani e caktuar për t'u konsideruar kompani efikase (x_c); dhe,
- Efekti i ndryshimit të kufirit të produktivitetit: Sa pritët të jetë përmirësimi i efikasitetit të kompanive më efikase (x_s).

Figura 3 Përcaktimi i faktorit të efikasitetit (efekti $x_c + x_s$)



Në këtë mënyrë, faktori i efikasitetit për një kompani të caktuar të rregulluar mund të llogaritet si:

$$X\text{-efikasiteti} = x_c + x_s$$

Gjatë shqyrtimit të kaluar periodik për rrjetin e shpërndarjes dhe të transmisionit, ZRRE kishte potencuar vështirësitë e përcaktimit të faktorit x_c në kontekst të kompanive të rregulluara në Kosovë që kanë të bëjnë me mungesën e mostrave të kompanive të krahasueshme mbi të cilat do të mund të përcaktohej



një faktor efikasiteti. Në mungesë të kësaj analize, ZRRE ishte përcaktuar që faktori i efikasitetit për kompanitë e rreguluara të reflektojë vetëm efektin e ndryshimit të kufirit të produktivitetit (x_s)⁷.

4.3.1.1 Efekti i ndryshimit të kufirit të produktivitetit

ZRRE propozon që efekti i përmirësimit të përgjithshëm të vendoset në bazë të precedanëve rregullator, në linjë me përcaktimin e faktorit të efikasitetit për rrjetet e rreguluara (OSSH dhe OST) gjatë shqyrtimit të tyre periodik. Vështirësia e përcaktimit të këtij efekti është që precedanët rregullator vendosen në sektorët e rregulluar infrastrukturor si rrjeti i shpërndarjes dhe rrjeti i transmissiionit, që mund të mos reflektojnë përmirësimet për furnizuesit e rregulluar. Megjithatë, si rrjetet ashtu edhe kompanitë e rreguluara të furnizimit përfitojnë nga përmirësimet teknologjike dhe automatizimi i proceseve që shtyjnë përmirësimet operative. Rrjedhimisht, përmirësimet e pritshme të ndryshimit të faktorit të produktivitetit në rrjete të rreguluara mund të reflektojnë përmirësimet në furnizuesit e rregulluar. ZRRE propozon sipas llogaritjeve që për FSHU-në të aplikohet faktor i efikasitetit që reflekton efektin e ndryshimit të kufirit të produktivitetit prej 0.75% që do të aplikohet në pjesën e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes që konsiderohen të kontrollueshme nga FSHU.

4.3.2 Përshtatjet për inflacionin

Metodologjia për aplikimin e këtyre përshtatjeve është e përcaktuar në Rregullën për Vendosjen e të Hyrave të FSHU-së. Inflacioni përshtatet duke reflektuar vlerën aktuale të inflacionit në vitin relevant t-1 që reflekton indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve (HICP) për të gjitha njësitë për shtete të Eurozonës (*Euro Area 20 countries*) e publikuar nga Eurostat⁸. Vlera mesatare e inflacionit për vitin 2024, deri në tetor është 2.28%. Kjo normë inflacioni është aplikuar në shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për të reflektuar ndikimin e saj në koston e përgjithshme të shpenzimeve operative por do të përshtatet për të reflektuar nivelin aktual në fund të vitit kurdo që kjo vlerë të publikohet nga Eurostat.

4.3.3 Përshtatjet e tjera të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes

FSHU në kërkesën për shpenzime tjera operative ka theksuar dy kosto të cilat kanë ndikim të dukshëm në nivelin e kostove për Operim dhe Mirëmbajtje:

- Kosto për vendosjen e faturave në zarfa të mbyllura, sipas kërkesës nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave, kosto e parashikuar e këtij detyrimi ligjor sipas vlerësimit të FSHU-së është €2mil në vit; dhe,
- Kosto për shërbimet e sigurimit, e cila pritet të rritet me aprovimin e nivelit të pagës minimale në vlerën 350€.

⁷ Raporti Konsultativ i ZRRE-së për vendosjen e faktorit të efikasitetit <https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Efficiency%20Factor%20%20Consultation%20Report.pdf>

⁸ Eurostat (2024). [HICP - monthly data \(annual rate of change\)](#).



Në parim ZRRE do të lejojë mbulimin e të gjitha shpenzimeve të arsyeshme që rrjedhin nga detyrimi për të plotësuar kërkesa ligjërish të obligueshme. Sa i përket kërkesës për mbulimin e kostove për vendosjen e faturave në zarfa të mbyllura, FSHU duhet të dorëzojë në ZRRE evidencë dhe informata të kënaqshme për ZRRE-në për nivelin e pritshëm të këtyre kostove, duke reflektuar hollësi më të detajuara të këtyre kostove. Niveli final i shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes do të përcaktohet në raportin përfundimtar pas ofrimit të informatave shtesë të FSHU-së dhe komenteve të palëve të interesit dhe mund të shqyrtohet edhe në Procesin e përshtatjeve të rregullta.

5 Propozimi për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përmbledhja e propozimit të ZRRE-së për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative.

Tabela 10: Propozimi i ZRRE-së për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative

Propozimi i ZRRE-së për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzime Operative për FSHU	Njësia	2025	2026	2027
Marzha me pakicë	%	2.54	2.54	2.54
Borxhi i keq	%	1.8	1.6	1.4
Faktori ndarës i jo-balanceve	%	100	100	100
Shpenzimet operative ⁹ pa efikasitet	€000	5,592		
Faktori i efikasitetit	%	0.75	0.75	0.75
Kategorizimi dhe jetëgjatësia e Aseteve:				
I. Mobicet, pajisjet për zyrë;	Vite	7	7	7
II. Pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat, Kompjuterët , pajisjet TI dhe softuerë		5	5	5

⁹ Niveli i lejuar i FSHU për vitin 2024 prej 5,467,389 i indeksuar me normë inflacioni prej 2.28% dhe që nuk përfshin përshtatjet shtesë të cekura në kapitullin 4.4.3 të këtij raporti.